

Komuna e Shtimes/Štimlje

Tahir (Brahë) Bungu

(1905, shqiptar nga Shtimja/Štimlje, bujk, tre fëmijë)

Tahiri i moshuar me familje jetonin në Shtime/Štimlje. Në tetor të vitit 1997, në shtëpinë e tij familjare kishin ardhur pesë policë [identiteti i njërit prej tyre është i njohur për FDH], të cilët e sollën thirrjen që nesër të lajmërohej në stacionin policor. Tahiri shkoi të nesërmen. Gjatë marrjes në pyetje, policët e ofendonin duke kërkuar që t'i dorëzonte armët. Ai u kishte thënë se i ka dorëzuar ato që i kishte. Një polic [emri i njohur për FDH] e shau në gjuhën shqipe dhe kur Tahiri iu kundërpërgjigj, policët filluan që ta rrihnin [Shtime/Štimlje]. Dy ditë më vonë, policia sërish kishte ardhur për ta kërkuar Tahirin. Njëri prej policëve i tha të birit të Tahirin, se kanë njohuri se Tahiri kishte blerë armë. Pas disa orësh, e kthyen të shkalluar dhe në gjendje shumë të rëndë. I biri e dërgoi në ambulancë. Por, Tahiri kurrë nuk u këndell dhe nga pasojat e lëndimeve ndërroi jetë më **23.01.1998**. Të nesërmen, familjarët e varrosën në varrezat e Shtimes/Štimlje.

Burimi: deklarata I.B, FDH-13651.

Sabri (Hasan) Ahmeti

(22.06.1932, shqiptar nga Carraleva/Crnoljevo, komuna e Shtimes/Štimlje, bujk, tetë fëmijë)

Në datën **17.06.1998**, zhvilloheshin luftimet ndërmjet forcave të UÇK-së dhe atyre policore afër fshatit Duhël/Dulje, në vendin e quajtur *Shtëpia e Pylltarëve/Šumareva kuća*. Rreth orës 14:00, policia duke u tërhequr nga fshati shtëni në të dy

anët e rrugës. Banorët që i kishin shtëpitë pranë rrugës u tërhoqën në brendi të fshatit. Në orën 19:30, forcat e mëdha policore e kishin rrethuar dhe e kanë bombarduar për një orë fshatin. Kur pushoi granatimi, njerëzit dolën nga bodrumet dhe u strehuan në pyllin e afërt. Sabriu ishte nisur, por u kthye për ta marr pushkën. Me të u nisën edhe djemtë e tij, Zaimi dhe Nexmedini, si dhe i vëllai Shabani. Me të arritur në oborrin e shtëpisë familjare [Carralevë/Crnoljevo], një predhë ka rënë afër tyre. Sabriu u qëllua në shpinë dhe ndërroi jetë në vend. Sabriun e varrosën dy orë pas mesnate në varrezat e fshatit.

Burimet: deklarata S.A, FDH-23582; deklarata A.Z, FDH-36716.

Feriz (Sabit) Ajeti

(1955, shqiptar nga Carraleva/Crnoljevo, komuna e Shtimes/Štimlje, punëtor fizik, i pamartuar)

Xhemajl (Sabit) Ajeti

(1963, shqiptar nga Carraleva/Crnoljevo, komuna e Shtimes/Štimlje, punëtor fizik, tre fëmijë)

Vëllezërit Xhemajli, Ferizi dhe Ramizi jetonin në Carralevë/Crnoljevo. Ferizi kishte probleme psikike. Ai jetonte me Ramizin në pjesën e epërme të fshatit, kurse Xhemajli me familje jetonin në pjesën e poshtme të fshatit. Në muajin qershor të vitit 1998, forcat serbe kishin hyrë në pjesën e poshtme të fshatit. Xhemajli me familje u zhvendosën te Ferizi dhe Ramizi. Shëndeti i Ferizit u përkeqësua dhe shpeshherë dilte nga shtëpia. Askush nuk e dinte ku shkonte.